



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2023
Nr. Dok. 202300559/2

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Delvinë.

Drejtuar: Z. Naim LALA
Shef i Komisariatit të Policisë Delvinë

DELVINË

Për dijeni: Z. Ermal MUÇAJ
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

VLORË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatin e Policisë Delvinë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr.81 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë Delvinë.

Inspektimi u krye në datën 09.06.2023, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës

standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, Urdhrit e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, që do të keni më poshtë:

Shënime paraprake

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit¹ në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me punonjësit e administratës në mungesë të Shefit të Komisarariatit të Policisë të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, stafi i punës së komisarariatit informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit vitin e kaluar, në lidhje me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati, sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me punonjësit e policisë që shërbenin në zyrën e informacionit dhe në dhomën e shoqërimit. Theksojmë se, punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij Komisaritati.

Në vijim u inspektuan ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, nga inspektimi i mëparshëm², rezultoi se:

- Ishte zbatuar rekomandimi për pajisjen e komisarariatit me regjistër për evidentimin e kërkesë /ankesave të personave të shoqëruar.
- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi për vendosjen në ambientet e komisarariatit Delvinë të posterave me të drejtat e personave të shoqëruar/ndaluar.

¹ Inspektimet e Avokatit të Popullit nuk janë inspektime të lajmëruara më parë.

² Rekomandimi i dërguar me shkresën nr. K4/I55-2 prot., datë 24.10.2022.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

- Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në procedurat standarde miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete duke respektuar standardet për femra, meshkuj dhe të mitur.
- Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore
- Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera për vëzhgimin e korridorit të ambientit të shoqërimit dhe në dhomën e marrjes në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar.
- Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave që karta e të drejtave për t'u informuar për ndalimin/arrestimin të garantohet në praktikë që nga fillimi i heqjes së lirisë.

Rezulton se niveli i investimeve në strukturat policore mbetet ende shumë i ulët në krahasim me nevojat.

Në përfundim të inspektimit, u konstatua se në ambientin e shoqërimit në Komisariatin e Policisë Delvinë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Delvinë ambientet e shoqërimit nuk ishin të ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në procedurat standarde: miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.938, dt. 24.07.2019, “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gra, meshkujt madhorë dhe të miturit.³

³ Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

Mjedisi i shoqërimit përbëhet nga 1(një) dhomë shoqërimi, e cila përdoret për meshkujt madhorë, ndërkohë që nuk kishte dhomë për shoqërimin e grave dhe të miturve.

Mungesa e dhomave të shoqërimit për gratë dhe të miturit në konflikt me ligjin është një problem thelbësor që paraqitet në këtë komisariat, duke mos siguruar garantimin e lirive, të drejtave dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e policisë, si dhe nevojave fizike dhe psikologjike, kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.

Sipërfaqja dhe hapësira e dhomës së shoqërimit ishte 4x3m dhe kishte kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur për 4 persona. Dhoma kishte një dritare e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishte ndriçim nga rrjeti elektrik.

Ajo ishte e pastër nga ana higjieno-sanitare ishte e pajisur me një stol të fiksuar në dyshe në mënyrë të palëvizshme, për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Ambienti i shoqërimit nuk kishte tualet brenda dhomës apo ngjitur me të, por si i tillë shërbente tualeti që përdoret nga personeli i komisariatit në katin e dytë të ndërtesës. Në komisariatit e Policisë Delvinë nuk kishte sistem ngrohje –ftohje, sikurse parashikohet në procedurën standarde.

Grupi i inspektimit konstatoi se, mungonte dhoma për intervistimin/marrjen në pyetje të personit të shoqëruar nga punonjësit e policisë, si dhe **nuk ishte i instaluar sistemi i kamerave për monitorimin** dhe mbajtjen në vëzhgim të këtyre ambienteve. Mungesa e këtyre elementeve përbëjnë shkelje të rregullave teknike dhe standardeve për shoqërimin e personave në mjediset e policisë.

Në Komisarariatit e Policisë Delvinë, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 09.06.2023 ishin të shoqëruar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit 28 persona sipas përcaktimeve të bëra përkatësisht në nenin 109 “*Shoqërimi në polici*” dhe në paragrafin 1 të nenit 112⁴ “*Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit*” të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*” i ndryshuar.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Mekanizmi Kombëtar

⁴ Paragrafi 1 i nenit 112 parashikon: “*Për të regjistruar nga ana administrative të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia kryen këto veprime: 1. Në rast shoqërimi, policia evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për: a) gjenealogjinë; b) vendbanimin; c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta; ç) punën që kryen; d) arsyet e shoqërimit; dh) orën, datën dhe vendin e shoqërimit; e) zyrën e policisë ku është kryer shoqërimi; ë) punonjësin e policisë, i cili ka kryer shoqërimin.*”

kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave në momentin e hyrjes në komisariat, për të garantuar të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj⁵.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisaratin e Policisë Delvinë, nuk kishte ambient sigurie. Personat e ndaluar/arrestuar pasi evidentoheshin në regjistrin përkatës dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarimit të Policisë Vlorë.

Regjistrat e personave të shoqëruar dhe evidentimi i tyre

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Delvinë, “*Regjistri i evidentimit të dhënave për personat e shoqëruar*” ishte i tipit “*Model nr. 1*” konform me procedurat standarde miratuar me Urdhrin nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Në rubrikat e regjistrit konstatuam **mungesën e plotësimit me saktësi të rubrikës “Të dhëna për njoftimin e familjarëve/ të afërmeve”** ku në pjesën më të madhe ishte shkruar vetëm “familjar”, ndërkohë që edhe në rastet ku ishte shkruar emri i personit që njoftohet, nuk ishte shkruar as numri i kontaktit të personit që njoftohet dhe as ora e njoftimit⁶.

Gjithashtu, në këtë Komisarimit administrohej regjistër për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar.

⁵ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici).

Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit.

Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>.

⁶ Kreu VII, procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Nga inspektimi, u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që kryhej inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë Delvinë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra **nuk ishin të monitoruara** dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto **zyra por është konstatuar se përsëri rekomandimi nuk është plotësuar**⁷.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Nga monitorimi që u krye në zyrat e punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

⁷ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]. Konsulto: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

Nga informacioni dhe pyetjet e punonjësit të informacionit në Komisarriatin e Policisë Delvinë rezultoi se, në rastet kur personat e shoqëruar në mjediset e policisë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Në rastet kur personat e ndaluar/arrestuar ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa asistenca e psikologut sigurohej nga shkolla e mesme e qytetit të Delvinës ose punonjësi në organikën të Bashkisë Delvinë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës të ambientit të shoqërimit ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar por këto postera mungonin brenda dhomës së shoqërimit të këtij komisarriati.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarriat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në procedurat standarde miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, **duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete duke respektuar standardet për femra, meshkuj dhe të mitur.**
2. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera për vëzhgimin e korridorit të ambientit të shoqërimit si dhe për krijimin e ambienteve të përshtatshme të pajisura me kamera audio-vizive për marrjen

në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

3. Marrjen e masave për plotësimin me korrektësi të të gjitha rubrikave të regjistrit sipas kërkesave të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.
5. Marrjen e masave për vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar jo vetëm në koridoret e ambientit të shoqërimit por dhe brenda ambientit të dhomës së shoqërimit.
6. Marrjen e masave për pajisjen e Komisarariatit të Policisë Delvinë me sistem ngrohje –ftohje, sikurse parashikohet në procedurën standarde.
7. Marrjen e masave për trajnimin e punonjësve me qëllim zbatimin me përpikmëri të parashikimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për personat e privuar nga liria.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ahmet Prençi

Punoi:

G. Çarkaxhiu